

VENDIM
Nr. 96, datë 14.2.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 372, DATË 18.5.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË KOMUNIKIMIT, KONSULTIMIT DYPALËSH DHE VENDIMMARRJES PËR LEJEN E MJEDISIT TË TIPIT A, PËR FUNKSIONIMIN E INSTALIMIT TË VENDOSUR NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QË KA MUNDËSI REALE TË KRIJOJË EFEKTE NEGATIVE TË KONSIDERUESHME NË MJEDISIN E NJË SHETI TJETËR OSE MENJËHERË PASI I KËRKOHEJ NGA KY SHETI"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 22, të ligjit nr.10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në tekstin e rregullave të komunikimit, konsultimit dypalësh dhe vendimmarrjes për lejen e mjedisit të tipit A, për funksionimin e instalimit të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që ka mundësi reale të krijojë efekte negative të konsiderueshme në mjedisin e një sheti tjetër ose menjëherë pasi i kërkohet nga ky shet, bashkëlidhur vendimit nr. 372, datë 18.5.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Shkronjat "b" e "dh", të pikës 2, shfuqizohen;

b) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1 Dokumenti 'Përmbledhja joteknike e raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkufitar' do të kërkohet gjatë këtij procesi, por ky dokument do të gjenerohet nga vetë ministria përgjegjëse për mjedisin dhe institucionet e saj të varësisë, të përfshira në këtë proces."

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Qendra Kombëtare e Biznesit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama